- pikatorja vendoset sa më afër syrit dhe hidhet sasia e duhur e pikave në "ulluk" (hullizë),
- syri mbyllet për dy minuta (por jo fort), lëngu që del hiqet me një gazë. Në rast se përdoren më tepër se një lloj pikash në sy, atëherë duhet të pritet të paktën 5 minuta përpara përdorimit të një lloji tjetër pikash për sy.

Nëse paraqitet si mjegull në sy, pas disa minutave ajo me lëvizjen e kapakëve qartësohet, kurse në kohën kur nuk shohim qartë, nuk duhet të ngasim makinën as të ushtrojmë punë, që kërkojnë përqendrim të shtuar.

Këshillohet në rastin e fëmijëve që ata të jenë të shtrirë me kokën të vendosur drejt dhe se pikat duhet të hidhen në këndin e syrit të mbyllur

Në formë të pikave për sy ndodhen: Dexamethason – Neomycin, Gentamicin, Bivacyn Visine, Pilocarpin Homatotropin etj.

TRETËSIRAT UJORE PËR SY (KOLIRET)

Në bazë të farmakopesë tretësirat ujore për sy janë preparate të lëngëta mjekuese që përdoren ose për ekzaminim të syrit ose për larjen dhe mjekimin e syrit.

YNDYRAT APO POMADAT PËR SY (OCULENTA)

Janë preparate mjekuese të cilat përdoren për mjekimin e syrit apo të kapakëve të tij. Në krahasim me pikat për sy kanë veprim më të gjatë. Duhet të aplikohen në mënyrë aseptike si dhe pikat për sy.

Edhe me pomada veprohet në mënyrë të njësojtë veçse, koka duhet të përulet pak prapa dhe pas përdorimit maja e tubës duhet të pastrohet me një gazë.

Në formë të yndyrave për sy ndodhen: *Dexamethason –Neomycin, Gentamicin, Bivacyn, Aciclovir, Chloramphenicol* etj.

SI T'I PËRDORIM KONTRACEPTIVËT ORALË?

Marrja e rregulltë e kontraceptivëve është njëri ndër kushtet elementare për shmangien e shtatzënisë. Marrja e drazheve (pilulave) duhet filluar nga dita e pestë e ciklit menstrual, pa marrë parasysh sa zgjasin menstruacionet 2-3 ose 6-7 ditë. Çdo ditë merret nga 1 drazhe pa ndërprerje gjatë 20, 21 ose 22 ditëve (kjo varet nga paketimi dhe udhëzimi, të cilin e ka bari i caktuar). Është e këshillueshme që bari të merret në të njëtjën kohë (orë) të ditës. Kur përfundon seria e parë (kutia) prej 21 drazheve, atëherë ndërpritet marrja e tyre, në mënyrë që pas 2-3 ditësh të shfaqen gjakderdhjet (menstruacionet). Ditën e pestë pas fillimit të gjakderdhjeve, prapë fillon seria e re, (siç u tha më lart). Numri më i madh i preparateve kontraceptive përmban 21 drazhe. Për t'u llogaritur më lehtë, tri javë merret bari, një javë pushim, e kështu me radhë.

Bari më së miri është të merret në mbrëmje. Në qoftë se në mbrëmje harrohet, mund të merret në mëngjes, por jo më vonë se



12 orë nga koha kur duhet të merret rregullisht. Në qoftë se nuk merret dy apo më tepër ditë radhazi, mundësia për të mbetur shtatzënë është e madhe dhe këshillohet që marrja e drazheve të ndërpritet shtatë ditë, në mënyrë që të fillojnë menstruacionet. Seria tjetër duhet të merret sikur ta filloni për herë të parë këtë mjekim me një kujdes më të madh në 15 ditët e para.

Në formë të preparateve kontraceptive orale(që përdoren nga goja) ndodhen*: Microgynon 30, Stederi, Stederil d, Stederil M, Neogynon 21, Frilavon, Marvelon , Legravan, Duphosal, Sequilar, Trinovum* etj.

QUMËSHTI ARTIFICIAL (FORMULA PËR FOSHNJE)

Qumështi i nënës (ushqimi në gji) është ushqim i pazëvendësueshëm për fëmijë. Ushqimi me gji kohëve të fundit, në kundërshtim me traditën shqiptare, pa arsye logjike dhe me argumente jobindëse si nga ana e nënës, por fatkeqësisht në disa raste edhe nga vetë mjeku po sfidohet nga qumështi artificial.



Në këtë manual (doracak) do të flasim për përdorimin e qumështit artificial vetëm atëherë kur është vërtet i domosdoshëm. Edhe pse qumështi artificial ka sasi të mjaftueshme të lëndëve ushqimore, shumë nëna për shkak të mënyrës së gabuar të përgatitjes, qumështit artificial ia zvogëlojnë këto vlera, andaj para se ta përgatitin duhet të ndalen në disa probleme të cilat paraqiten. Në udhëzim të çdo prodhimi ndodhet edhe tabela e cila tregon për sasinë (dozën), e cila i nevojitet fëmijës sipas moshës. Ajo është e llogaritur për t'i plotësuar nevojat e një racioni. Në anën tjetër janë të dhëna edhe racionet (se sa herë në ditë duhet të ushqehet me sasi të tilla).

Problem tjetër paraqitet mënyra se si përgatitet. Në princip të gjitha llojet e qumështit të adaptuar (artificial) përgatiten në këtë mënyrë:

- Uji i matur në mililitra të caktuar vlohet dhe pastaj ftohet në afro 55 º C
- Uji i ftohur në këtë temperaturë qitet në shishe me grykë të gjerë.
- Sasia e përshkruar e qumështit pluhur (shiko tabelën) qitet në shishe
- Shishen tundeni mirë në mëyrë që të tretet e gjithë sasia e pluhurit
- Lihet të ftohet deri në temperaturë trupore 37º C dhe i jepet fëmijës.

Vërejtje: Qumështi gjithmonë duhet të përgatitet i freskët.

Në formë të qumështit të adaptuar ndodhen: *Humana 1, 2, 9, Lactovit, Bebilac 1, 2, Milupa, Aptamil* etj.

1.Uji i zier (105º C)
dhe i ftohur (55º C)

2. Uji i ngrohtë (afër 50ºC)
qitet në shishe(2/3)

3. Hidhen lugët matëse
(varësisht nga sasia)

4. Përzihet

5. Plotësohet
me sasinë e mbetur

6. Përzihet



7. Pasi të jetë ftohur (në temp. 37º C), provohet me shpinën e dorës, në mënyrë që të shohim se është ftohur dhe pastaj i jepet fëmisë që ta pijë.

L[10,11,13,15,30,31,32,42,43,59,63,71]

GRUPET E BARNAVE

Barnat janë të ndara në 14 grupe kryesore anatomike

A Barnat që veprojnë *në traktin digjestiv dhe në metabolizëm (gojë , lukth, zorrë etj.)*
B Barnat që veprojnë *në gjak dhe në organet gjakkrijuese*
C Barnat që veprojnë *në sistemin kardiovaskular(enë të gjakut, zemër etj.*
D Barnat që veprojnë *në lëkurë –dermatologjikët*
G Barnat që veprojnë *në sistemin urogjenital dhe hormonet seksuale*
H *Barnat sistematike hormonale me përjashtim të hormoneve seksuale*
J Barnat për shërimin e infeksioneve sistematike – *antiinfektivët sistematikë*
L Barnat për mjekimin e sëmundjeve të rënda – *antineoplastikët dhe imunosuprezivët*
M Barnat që veprojnë *në sistemin e muskujve eshtërorë*
N Barnat që veprojnë *në sistemin nervor qendror*
P Barnat për shërimin e infeksioneve që i shkaktojnë parazitët – *antiparazitikët*
R Barnat që veprojnë *në sistemin respirator*
S Barnat që veprojnë *në organet e të dëgjuarit*
V Të ndryshme

TABELAT E DISA BARNAVE TË GRUPUARA NË GRUPE TERAPEUTIKE QË KËRKOJNË KUJDES GJATË PËRDORIMIT

A.BARNAT QË VEPROJNË NË TRAKTIN DIGJESTIV DHE NË METABOLIZËM (GOJË, LUKTH, ZORRË ETJ.)

Emri i preparatit	Përmbajtja	Mënyra e përdorimit	Vërejtjet
Alpha D3	Alfakalcidol	Në çdo 6-8 orë	Mund të merret me ushqim ose pa te
Alfogel, Phosphalugel	Fosfat alumini	Në çdo 8 - 24 orë	1-2 orë pas ushqimit. Suspensionet pihen me pak uj ose qumshtë.
Amaryl	Glimepirid		Bari merret gjatë ushqimit në mëngjes.
Ananase	Bromelin	Në çdo 6-8 orë	
Astemisan, Alsten, Histazol	Astemizol	Në çdo 24 orë	Në mëngjes para ushqimit
Atoris, Tulip	Atrovastatinë	1x1	Në mbrëmje merret para ose pas ushqimit. Preferohet të merret në të njëjtën kohë çdo ditë.
Avacan	Kamilofin	Në çdo 8 - 12 orë	
Bacit, Lesux	Subcitrat bizmuti		30 minuta para ushqimit
Bedoksin, Vitamin B6, PlivitB6, Piridoksin	Piridoksin	Në çdo 8 orë	Kujdes kur kombinohet me Levodopën
Bronal, Tefen	Terfenadin	Në çdo 12 orë	Ose dozat e mëdha në mëngjes
Buscopan	Butilskopolaminë	Në çdo 6-8 orë	Merret vetëm derisa të ndalen dhimbjet
Daonil, Diabos, Glibedal, Maninil	Glibenklamid	Dozimi bëhet në bazë të udhëzimit të mjekut	Gjatë ngrënjes së mëngjesit. Duhet të kontrollohet doza kur merret Aspirinë, Andol etj.
Diabenes	Klorpropamid	Dozimi bëhet në bazë të udhëzimit të mjekut	Gjatë ngrënjes së mëngjesit. Duhet të kontrollohet doza kur merret Aspirinë, Andol etj.

Emri i preparatit	Përmbajtja	Mënyra e përdorimit	Vërejtjet
Controloc	Pantoprazo	1x1	Në mëngjes para ushqimit
Ca Pangamat, Calgam	Pangamat kalciumi	Në çdo 8 orë	
Dimidril	Difenhidraminë	Në çdo 6-8 orë	Ngasit e makinave nuk duhet të përdorin 4 orë para nisjes
Dramamine	Dimenhidrinat	Në çdo 4-6 orë	1 orë para udhëtimit
Dulcolax, Novolax	Bisakodil	Në çdo 24 orë	Në mbrëmje
Galitidin	Nizatidin	Në çdo 12-24 orë	
Gelusil – Lac, Masigel K	Tresilikat Mg, Al (simaldrat)	Në çdo 4-8 orë	1-2 orë pas ushqimit. Tabletat shkrihen në gojë. Pluhuri tretet në ujë ose lëngje. Suspensionet pihen me pak uj ose qumshtë.
Metformin, Gluformin, Siofor, Glucophage	Metforminë	Dozimi bëhet në bazë të udhëzimit të mjekut	Merret gjatë ushqimit. Duhet të kontrollohet doza kur merren aspirina, andoli etj.
Gastrozem	Pirenzepin	Në çdo 12 orë	Para ushqimit
Kalcijev karbonat, Kalcium karbonat	Karbonat kalciumi	Në çdo 4-8 orë	Para ushimit ose dy orë pas ushqimit
Gastal	Hidroksid Al, Mg dhe karbonat Mg	Në çdo 4-8 orë	1-2 orë pas ushqimit. Tabletat shkrihen në gojë. Pluhuri tretet në ujë ose lëngje. Suspensionet pihen me pak uj ose qumshtë.
Himekromon, Mendiaxon	Himekromon	Në çdo 8 orë	30 minuta para ushqimit
Klometol, Reglan	Metoklopramid	Në çdo 8 orë	15 minuta para ushqimit
Kalium, Rekawan	Klorid kaliumi	Në çdo 8 orë	

Emri i preparatit	Përmbajtja	Mënyra e përdorimit	Vërejtjet
Kavitamin	Menondion Vitamin K_3	Në çdo 8-24 orë	Nuk duhet të merret në javën e fundit të shtatzënisë dhe dëmtimet e mëlçisë. Jep reaksione alergjike të lëkurës
Lanzul, Opagis	Lansoprazo	1x1	Në mëngjes para ushqimit
Lentostamin	Klorfenamin	Në çdo 12 orë	
Loperamid, Seldiar	Loperamid	Në çdo 8-24 orë	Nuk duhet të merret në shtatzëni, nën moshën 2 vjeçare dhe insuficinencën e mëlçisë
Lyobif	Lactobacillus bifidus	Në çdo 6 - 8 orë	Para ushqimit
Natrium pikosulfat	Pikosulfat natriumi	Në çdo 24 orë	Në mbrëmje
Omeprol, Omeprazol, Ultop, Losec, Ulcosan	Omeprazol	Në çdo 24 orë	Në mëngjes para ushqimit, me pak ujë
Oxetal, Tinset	Oksatomid	Në çdo 12 orë	Pas ushqimit
Panthenol	Dekspantenol	Në çdo 4-12 orë	Treten në gojë pas ushqimit
Phenergan	Prometazin	Në çdo 12-24 orë	Më së miri në mbrëmje. Tabletat nuk guxojnë t'i përdorin fëmijët nën moshën 2 vjeçare. Kujdes ngasit e makinave
Plivit A	Retinol	Në çdo 24 orë	
Plivit D3	Kolekalciferol	Në çdo 24 orë	Bashkë me ushqim
Ranital, Ranisan, Ranitidin, Peptoran, Ulcodin	Ranitidin	Në çdo 12 orë	Në mëngjes dhe në mbrëmje, pavarësisht nga marrja e ushqimit.
Rudakol, Celofac	Mebeverin	Në çdo 8 orë	30 minuta para ushqimit
Rupurut	Hidrotalcit		2 orë pas ushqimit
Synopen	Klorpiramin	Në çdo 12 orë	

Emri i preparatit	Përmbajtja	Mënyra e përdorimit	Vërejtjet
Vitamin B1, Plivit B1, Tiamin	Tiamin	Në çdo 8-24 orë	Pas ushqimit
Vitamin B12, Antipernicin, Cijanokobalamin	Cijanokobalamin	Në çdo 24 orë	Para ushqimit
Ulfamid, Famosan, Famotidin, Lecedil	Famotidin	Në çdo 24 orë	Para gjumit. Nuk duhet të përdoret në shtatzëni dhe laktacion
Vitamin C, Plivit C	Acid askorbik	Në çdo 6-8 orë	
Vitamin E, Tocopherol	Tokoferol acetat	Në çdo 8-24 orë	

Preparatet e kombinuara

Emri i preparatit	Përmbajtja	Mënyra e përdorimit	Vërejtjet
Beviplex, B Complex, Plibex, Poplibevit	Vitamina B1 + B2 + B5 + B6 + B7 + B12, kolin PABA	Në çdo 8–24 orë	
Ca C 500	Karbonat kalciumi + laktoglukonat kalciumi + acid askorbik	Në çdo 8-12 orë	E shkrirë në një gotë ujë para ushqimit
Ca Sandoz forte	Karbonat kalciumi + laktoglukonat kalciumi	Në çdo 6-12 orë	E shkrirë në një gotë ujë para ushqimit
Cevicalcit	Glukonat kalciumi + acid askorbik	Në çdo 6-12 orë	E shkrirë në një gotë ujë para ushqimit
Chymoral 100 forte	Tripsin + himotripsin	Në çdo 8 orë	Para ushqimit
Digestal,Festal , Optilaza	Pankreatin + hemiceluloz + ekstrat të tëmëlthit (vrerit)	Në çdo 8 orë	Pas ushqimit, me pak ujë
Essentiale forte	Fosfolipide esenciale	Në çdo 8 orë	Gjatë ushqimit me pak ujë

Emri i preparatit	Përmbajtja	Mënyra e përdorimit	Vërejtjet
Flonivin BS	Kultur të sojës Bacillus	Në çdo 6-8 orë	Ndërmjet ushqimit
Linex	Lactobacillus + streptococcus	Në çdo 8 orë	Me pak lëngje
Lekovit C - Ca	Karbonat kalciumi + acid askorbik	Në çdo 8-12 orë	E shkrirë në një gotë ujë para ushqimit
Medilax, Babylax	Laurilsulfoacetat + glicerol	Në çdo 24 orë	Pasi të zbrazet klizma, e shtypur duhet të mbahet deri sa të largohet nga vendi i aplikimit.
Oligovit	Vitamina A + B1 + B2 + B5 + B6 + B7 + B12 + C + D + E + Ca + Co + Cu + Fe + K + Mg + Mn + Mo + Zn	Në çdo 24 orë	Gjatë ushqimit. Nuk duhet të merret gjat shtatzanisë (pas muajit të tret)
Pankreatin	Pankreatin + lipaz + amilaz + proteaz	Në çdo 12-24 orë	Gjatë ushqimit
Panzynorm forte	Tripsin + himotripsin + pepsin + lipaz + amilaz + acid holik	Në çdo 12 - 24 orë	Pas ushqimit, me pak ujë
Sanovit	Vitamina A + B1 + B2 + B5 + B6 + B7 + C + D + E + Ca	Në çdo 8-12 orë	
Vidaylin M	Vitamina A + B1 + B2 + B5 + B6 + B7 + C + D + kolin + PABA + Ca + J + Fe + Mg + Mn + P + Zn	Në çdo 24 orë	
Vitamin A + D3, Plivit A + D3	Retinol + kolekalciferol	Në çdo 24 orë	
Vitamin AD	Retinol + ergokalciferol	Në çdo 24 orë	Me ushqim

B. BARNAT QË VEPROJNË NË GJAK DHE NË ORGANET GJAKKRIJUESE

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Almetex	Karbazokromsulfat natriumi	Në çdo 4- 6 orë	Nuk duhet të përdoren barna që ndërveprojnë si Aspirina etj
Dicynone	Etamsilat	Në çdo 6 orë	Nuk duhet të përdoren barna që ndërveprojnë si Aspirina etj
Dipiridamol , Persadil, Persantin	Dipiridamol	Në çdo 6- 8 orë	Shkakton nauze, vjellje, diare, hipotension dhe keqësim të migrenës
Ferro gradumet, Retafer	Fero sulfat	Në çdo 24 orë	Në mëngjes para ushqimit
Heferol	Fero (Fe) fumarat	Në çdo 24 orë	Në mëngjes 30 minuta para ushqimit
Legofer	Feri (Fe) protein sukcinat	Në çdo 8 orë	Para ushqimit
Orferon	Fero (Fe) glicin sulfat	Në çdo 24 orë	Në mëngjes para ushqimit
Pelentan	Etil biskumacetat	Marrja duhet të bëhet me kujdes në bazë të analizave të gjakut	Nuk duhet të përdoren barna që ndërveprojnë si Aspirina etj
Sinomar, Syncumar	Acenokumarol	Marrja duhet të bëhet me kujdes në bazë të analizave të gjakut	Nuk duhet të përdoren barna që ndërveprojnë si Aspirina etj

Preparatet e kombinuara

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Eryfer	Fero sulfat + bikarbonat natriumi + acid askorbik	Në çdo 12 orë	Pas ushqimit
Retafol	Fero sulfat + acid folik	Në çdo 24 orë	

C. BARNAT QË VEPROJNË NË SISTEMIN KARDIOVASKULAR (ENË TË GJAKUT, ZEMËR ETJ.)

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Adalat, Cordipin, Nifelat, Nifecard	Nifedipin	Në çdo 8 -12 orë	Pas ushqimit.Te rastet kritike tableta grimëcohet dhe shkrihet nën gjuhë.
Adavin	Nicergolin	Në çdo 8 orë	Shkakton pengesa gastrointenstinale dhe nauze
Aldactone, Spironolacton	Spironolakton	Në çdo 12-24 orë	Në mëngjes
Aldizem, Cortiazem retard, Diltiazem	Diltiazem	Në çdo 8 orë	Nuk duhet të merret bashkë me Atenolol, dhe Prinorm
Aldomet, Methyldopa	Metildopa	Në çdo 8-12 orë	Gjatë ushqimit
Alkadil, Katopil, Zorkaptil	Kaptopril	Në çdo 8-12 orë	Para ushqimit
Amiodaron, Cordarone	Amiodaron	Në çdo 8 orë	
Amlodipin	Amlodipin	Në çdo 24 orë	Nuk duhet të merret në shtatzëni , laktacion dhe dëmtim të mëlçisë. Jep dhembje koke, edema dhe lodhje
Arifon, Lescoprid, Amoron	Indapamid	Në çdo 24 orë	Në mëngjes pas ushqimit
Atenolol, Prinorm	Atenolol	Në çdo 24 orë	Nuk duhet të merret bashkë me Verapamil , Diltiazem dhe glikozide kardiotonike

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Bloxan, Presolol, Metoprolol	Metoprolol	Në çdo 12 - 24 orë	Kujdes! Terapioni nuk duhet të ndërpritet shpejt
Boluzin, Sinelip, Elmogen	Gemfibrozil	Në çdo 12 -24 orë. Në raste të rënda 1 në mëngjes dhe 2 në mbrëmje-gjysmë ore para ushqimit	Më së miri në mbrëmje. Merret me ushqim dhe me pak ujë. Nuk duhet të merret bashë me kontraceptivë
Catapresan	Klonidin	Në çdo 8 orë	Shkakton bradikardi, tharje të gojës, dhembje koke dhe depresion. Ndërprerja e terapionit duhet të bëhet gradualisht
Cedigalan, Cedilanid	Lanatozid C	Në çdo 24 orë	Kujdes gjatë kombinimit me vitaminën D
Cinarizin, Cinedil, Stugeron forte	Cinarizin	Në çdo 8-24 orë Pas ushqimit, dy orë para udhtimit	Kujdes ngasit e automjeteve, sidomos në fillim të terapionit
Complamin	Ksantinol nikotinat	Në çdo 12 orë	Nuk duhet të përdoret në shtatzëni, laktacion dhe ulcerë peptike
Cornilat, Isosorb, Izosorb R, Tinidil	Izosorbid dinitrat	Në çdo 6-12 orë	Pas ushqimit. Gjatë terapionit mund të ket rënie të shpejtë të shtypjes së gjakut. Duhet të pasur kujdes gjatë ngritjes kur jemi ulur
Dartelin, Trental, Pentilin, Penthoxyphillin	Pentoksifilin	Në çdo 8-12 orë	Pas ushqimit. Kujdes te përdorimi në të njëjtën kohë me Ranitalin, Ulfamidin etj.
Digicor, Dimecor, Lanitop	Medigoksin	Në çdo 12-24 orë	Kujdes, gjatë kombinimit me vitaminën D

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Dilacor, Lanicor, Digoxin	Digoksin	Në çdo 12-24 orë	Kujdes ! Intoksikacioni në qoftë se merret së bashku me diuretik dhe pa kalium
Dilcoran 80, Pentoral	Pentaeritritol tetranitrat	Në çdo 12 orë	Gjatë ushqimit me pak ujë
Dipresan	Gvanfacin	Në çdo 8-24 orë	
Ditamin	Dihidroergotamin	Në çdo 12-24 orë	Më së miri në mëngjes dhe në mbrëmje
Dusodril	Naftidorfuril	Në çdo 8 orë	Shkakton nauze dhe konvulzione
Ebrantil	Urapidil	Në çdo 24 orë	Nuk duhet të merret në shtatzëni. Shkakton marramendje dhe djersitje
Effortil	Etilefrin	Në çdo 8 orë	Para ushqimit, me pak ujë. Fëmijëve me çaj të ëmbëlsuar
Enalapril, Enap, Olivin	Enalapril	Në çdo 24 orë	Nuk duhet të merret në shtatzëni, laktacion dhe në sëmundjet renovaskulare
Envacar	Gvanoksan	Në çdo 24 orë	
Fenofibrat, Katalip	Fenofibrat	Në çdo 12 orë	Më së miri në mbrëmje gjatë ushqimit
Gilurytmal	Ajmalin	Në çdo 8 orë	
Inderal, Propranolol	Propranolol	Në çdo 24 orë	Terapioni nuk duhet të ndërpritet shpejt
Isoptin, Izopamil, Lekoptin, Verapamil	Verapamil	Në çdo 8 –12 orë	Nuk guxon të merret bashkë me Atenololin dhe Prinormin (betablokator)

Emri i preparatit	***Përmbajtja***	***Mënyra e përdorimit***	***Vërejtjet***
Izomonit, Monizol	Izosorbid mononitrat	Në çdo 12 orë	Merret pas ushqimit dhe sipas nevojës
Kinidin drule, Chinidinum	Kinidin sulfat	Në çdo 12 orë	
Korapies	Dizopiramid	Në çdo 6-8 orë	Kujdes te glaukoma dhe hipertrofia e prostatës, dëmtimit të veshkave dhe mëlçisë. Shkakton retension urinar, tharje të gojës, çrregullime në të pamur etj.
Lasix, Fursemid, Edemid,	Furosemid	Në çdo 24-48 orë	Pas mëngjesit
Lipomal	Probukol	Në çdo 12 orë	Gjatë ushqimit
Lopion, Molicor	Molsidomin	Në çdo 12 orë	Pas ushqimit
Minepres, Minebar	Prazosin	Në çdo 8-12 orë	Shkakton pagjumësi, dhimbje koke, nauze dhe dobësi të përgjithshme
Minsetil	Meksiletin	Në çdo 6-8 orë	Shkakton konvulzione dhe çrregullime psikike
Nimodipin, Nimotop	Nimodipin	Në çdo 6 orë	Para ushqimit
Nitrepin, Unipres	Nitrendipin	Në çdo 12-24 orë	Pas ushqimit
Nitro Mack Retard,	Gliceril trinitrat	Në çdo 12 orë	Me pak ujë
Nitroglicerin, Nitroglicerol, Nitroglycerin	Gliceril trinitrat	Në çdo 24 orë	Sipas nevojës (sulmit)
Novocamid	Prokainamid	Në çdo 3-6 orë	
Paginol	Penbutolol	Në çdo 12-24 orë	Terapioni nuk duhet të ndërpritet shpejt

Emri i preparatit	***Përmbajtja***	***Mënyra e përdorimit***	***Vërejtjet***
Prajmalin	Prajmalin bitartarat	Në çdo 6-8 orë	Nuk duhet të merret në tremujorin e parë të shtatzënisë
Prilazid	Cilazapril	Në çdo 24 orë	Nuk duhet të merret në shtatzëni, laktacion dhe stenozë të aortës. Kujdes gjatë kombinimeve me kalium dhe diuretikë që e ruajnë kaliumin. Duhet të merret gjithmonë në të njëjtë kohë (interval)
Propafen, Prolekofen, Rytmonorm	Propafenon	Në çdo 8-24 orë	Pas ushqimit
Redergin, Redicor	Dihidroergotoksin	Në çdo 8 - 12 orë	Duhet të merret me ushqim apo qumësht
Renese	Politiazid	Në çdo 12-24 orë	Pas ushqimit
Selectol	Celiprolol	Në çdo 8-24 orë	Terapioni nuk duhet të ndërpritet shpejt
Sympatol	Oksiderin tartarat	Në çdo 8 orë	Para ushqimit
Tifendil	Fendilin	Në çdo 8 orë	
Tritace	Ramipril	Në çdo 24 orë	Me pak lëngje gjatë ose pas ushqimit
Venor	Betahidroksil rutezid	Në çdo 8-12 orë	Nuk duhet të merret në tremujorin e parë të shtatzënisë. Shkakton pagjumësi , dhembje koke shqetësime etj.
Yrinex	Bumetadin	Në çdo 24-48orë	Pas mëngjesit

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Simvastatin, Zocor, Vasilip, Hollesta	Simvastatin	Në çdo 24 orë	Në mbrëmje

Preparatet e kombinuara

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Acenosin, Brinerdin	Klopamid + rezerpin + dihidrokristin maleat	Në çdo 12-24 orë	
Alatan	Metildopa + hidroklortiazid + amilorid	Në çdo 12-24 orë	
Anaton, Enap H	Enalapril + hidroklortiazid	Në çdo 12-24 orë	
Birezid	Rezerpin + hidroklortiazid	Në çdo 12-24 orë	Me pak ujë
Birezid K	Rezerpin + hidroklortiazid klorid kaliumi	Në çdo 12-24 orë	
Delmeson	Flurometolon + neomicin + aminokinurid + feniramin		
Essaven	Escin + fosfolipide esenciale	Në çdo 8 orë	
Faktu	Krezolsulfon formaldehid + cinhokain		
Hemopres Moduretic	Amilorid + Hidroklortiazid	Në çdo 12-24 orë	Në mëngjes pas ushqimit
Hepathrombin	Heparin + alantoin + dekspanthenol		
Hepathrombin H	Heparin + prednizolon + dekspanthenol		
Lasonil	Heparinoid + hijaluronidaz		

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Lipostabil	Fosfolipide esenciale + teofilin	Në çdo 8 orë	Para ushqimit
Lometazid	Amilorid + Metiklotiazid	Në çdo 24 orë	Pas mëngjesit
Modolex	Dobesilat kalcium + lidokain	Në çdo 12 orë	Shiko përdorimin e suposieve dhe pomadave për hemorroide
Modolex plus	Dobesilat kalcium + lidokain + deksametazon	Në çdo 12 orë	Shiko përdorimin e suposieve dhe pomadave për hemorroide
Polyflex	Prazosin + politiazid	Në çdo 24 orë	
Sinepres	Dihidroergotoksin + hidroklortiazid rezerpin	Në çdo 24 orë	
Tenzimet	Pindol + klopamid	Në çdo 24 orë	Pas mëngjesit
Tiaren	Triamteren + hidroklortiazid	Në çdo 24 orë	Pas mëngjesit
Trirezid K	Rezerpin + dihidralazin + hidroklortiazid klorid kaliumi	Në çdo 8-12 orë	

D. BARNAT QË VEPROJNË NË LËKURË – DERMATOLOGJIKËT

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Aciklovir, Virolex, Zovirax	Aciklovir	Në çdo 4 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Afloderm	Alkometazon	Në çdo 8-12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Aknoten,VitacidA	Tretinoin	Në çdo 8-24 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Amracin	Tetraciklin	Në çdo 8-12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Antopar	Benzoilperoksid	Në çdo 12-24 orë	Fytyra apo vendi i sëmurë shpëlahet me ujë të vakët dhe thahet (teret) menjëherë. Dy ditët e para lyhet njëherë në ditë dhe lihet të veprojë dy orë, pastaj pastrohet ditën e tretë dhe të katërt lihet 4 orë etj.
Beloderm, Betamet, Kuterid	Betametazon	Në çdo 12-24 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Benzyl Benzoat, Scabitox	Benzil benzoat	Në çdo 24 orë	Tri ditë, më së miri në mbrëmje
Betadine, Povidon jod	Povidon jod	Në çdo 8-12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Bicutrim	Bifonazol	Në çdo 8-12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Bubil	Piretrin	Një herë , në qoftë se është nevoja përsëritet pas një jave	Shiko te përdorimi i shamponit kundër morrave
Canesten, Kansen, Plimcol	Klotrimazol	Në çdo 8-12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Chloramphenicol	Kloramfenikol	Në çdo 8-24 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Daktanol, Daktarin	Mikonazol	Në çdo 12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Decotal	Diflukortolon	Në çdo 8-12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Dermazin	Sulfadiazinargjendi	Disa herë (Në çdo 4 orë)	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Ecalin, Mitekol	Ekonazol	Në çdo 12-24 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Esperson	Dezoksimetazon	Në çdo 8-12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Eurax	Krotamiton	Në çdo 24 orë	Tri ditë, më së miri në mbrëmje
Gamex, Gatox, Milinor	Gama benzenheksaklorid	Një herë, në qoftë se është nevoja përsëritet pas një jave	Shiko te përdorimi i shamponit kundër morrave
Garamicin, Gentamycin	Gentamicin	Në çdo 6-12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Hydocortison	Hidokortizon	Në çdo 8 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Metosyn	Fluocinonid	Në çdo 6-8 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Myco Polycid	Klormidazol	Në çdo 12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Mycosep, Oronazol	Ketokenazol	Në çdo 12-24 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Nistatin, Nystatin	Nistatin	Në çdo 8-24 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Obytin	Ciklopiroksolamin	Në çdo 12-24 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Panthenol	Dekspanthenol	Në çdo 8-12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Phenergan	Prometazin	Në çdo 6-12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Pilfud, Regaine	Minoksidil	Në çdo 12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Stanicid	Fusidin	Në çdo 8-12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Synolar, Sinoderm	Fluocinolon acetonid	Në çdo 8-12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë. Të përdoret sa më shkurt sidomos te fëmijët. Pomada përdoret te lëkura e thatë kurse kremi te lëkura yndyrore
Synopen	Klorpiramin	Në çdo 8-12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Ultralan	Fluokortolon	Në çdo 8-12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Viru Merz Serol	Tromantadin	Në çdo 6-8 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë

Preparatet e kombinuara

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Aknasept	Mikonazol + benzoilperoksid	Në çdo 24 orë javën e parë. Në çdo 12 orë javën e dytë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Belosalic	Betametazon + acid salicilik	Në çdo 12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Bivacyn, Enbecin, Nebacettil	Bacitracin + neomicin	Në çdo 6 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Criniton	Acid salicilik + timol + oleum rozzmarini + izopropanol	2 herë në javë	Pas 15 –30 minutash të lahen flokët
Daktacort , Mikoderm	Mikonazol + hidrokortizon	Në çdo 12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Dexamethason Neomycin	Deksametazon + neomicin	Në çdo 8-24 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Diproderm, Diprogent, Kuterid G	Betametazon + gentamicin	Në çdo 12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Farmacyclin, Geocorton, Hydrocyclin, Terra Cortill	Hidrokortizon + oksitetraciklin	Në çdo 8-12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Jecoderm	Vaj peshku + vitamina	Në çdo 12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Kenalog G	Triamcinolon + acid salicilik	Në çdo 6-8 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Kenalog S	Triamcinolon + halkinol	Në çdo 6-8 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Locacorten N	Flumetazon + neomicin	Në çdo 8-12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Locacorten Tar	Flumetazon + acid salicilik + katran	Në çdo 12-24 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Locacorten Vioform	Flumetazon + kliokinol	Në çdo 8-12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Locasalen	Flumetazon + acid salicilik	Në çdo 12-24 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Lotrison	Flumetazon + triklozon	Në çdo 8-12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Neo Lemond	Metilprednizon + neomicin sulfat	Në çdo 12-24 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Satar	Acid salicilik + acid qumshti + jod	Në çdo 8 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Synolar N	Fluocinolon + neomicin	Në çdo 8-12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Vipsogal	Betametazon + fluocinonid + acid salicilik + dekspantenol + gentamicin	Në çdo 12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë
Vipsogal SG	Betametazon + fluocinonid + acid salicilik + dekspantenol	Në çdo 12 orë	Të lyhet lëkura në shtresë të hollë

G.BARNAT QË VEPROJNË NË SISTEMIN UROGJENITAL DHE HORMONET SEKSUALE

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
5 Nok, Nikopet	Nitroksolin	Në çdo 6 orë	Bari merret me mjaft ujë në mes ushqimeve
Alfuran, Nitrofurantoin retard	Nitrofurantoin	Në çdo 6-8 orë	Me ushqim
Bromergon, Bromokriptin	Bromokriptin	Në çdo 8-24 orë	Me ushqim
Bactogram, Negram	Acid nalidiksik	Në çdo 6 orë	Nuk duhet të përdoret në tremujorin e parë të shtatzënisë dhe në laktacion
Endometril	Linestrenol	Në çdo 12-24 orë	Duhet të përdoret doza e plotë në bazë të rekomandimit të mjekut
Ergotyl, Methylergometrin	Metilergometrin	Në çdo 8 orë	Duhet të kenë kujdes nënat që mos t'i japin fëmijës gabimisht në vend të pikave AD3
Levantin	Nifurtoinol	Në çdo 6 orë	Pas ushqimit
Nolicin, Nofocin	Norfloksacin	Në çdo 12 orë	Pas ushqimit
Palin, Pimidel, Pipegal, Pipem, Uripam	Acid pipemidik	Në çdo 12 orë	Duhet të pihet me ujë të mjaftueshëm
Trianol	Ekstrakt i Pyogeum africanum	Në çdo 12 orë	Para ushqimit
Urisept	Acid piromidik	Në çdo 6-12 orë	
Urotrim, Trilaprim	Trimetoprim	Në çdo 12 orë	

KONTRACEPTIVËT ORALË

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Cyclo Progynova	Estradiol + norgestrel	Në çdo 24 orë	Fillohet nga dita e pestë e ciklit menstrual. Pas çdo cikli 7 ditë pushim, duhet të merren në kohë të njëjtë Duhet të merren me rregull dhe në bazë të udhëzimeve të mjekut
Frilavon	Dezogestrel + etinilestradiol	Në çdo 24 orë	Së pari fillohet prej ditës së parë të ciklit menstrual, pastaj 7 ditë pushim
Legravan	Etinestradiol + levonorgestrel	Në çdo 24 orë	Fillohet nga dita e pestë e ciklit . Pas çdo cikli 7 ditë pushim, duhet të merren në kohë të njëjtë Duhet të merren me rregull dhe në bazë të udhëzimeve të mjekut
Microgynon 30, Sequilar, Duophasal (Ndryshojnë vetëm në dozë)	Levongestrel + etinilestradiol	Në çdo 24 orë	Së pari fillohet prej ditës së parë të ciklit menstrual kurse seria tjetër prej ditës së 5 të ciklit menstrual Duhet të merren me rregull dhe në bazë të udhëzimeve të mjekut
Stederil, Stederil M, Stederil d (Ndryshojnë vetëm në dozë)	Norgestrel + etinilestradiol	Në çdo 24 orë	Prej ditës së 5 të ciklit menstrual. Duhet të merren me rregull dhe në bazë të udhëzimeve të mjekut
Trinovum	Noretisteron + etinilestradiol	Në çdo 24 orë	Së pari fillohet prej ditës së parë të ciklit menstrual, pastaj 7 ditë pushim Duhet të merren me rregull dhe në bazë të udhëzimeve të mjekut

PËR TERAPION VAGINAL

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Albothyl	Krezolsulfon formaldehid	Në çdo 24 orë	Në mbrëmje. Vaginaletet duhet të lagen dhe të futen sa më thellë
Betadine, Povidon jod	Povidon jod	Në çdo 24 orë	Në mbrëmje. Vaginaletet duhet të lagen dhe të futen sa më thellë
Canesten, Kansen, Plimycol	Klotrimazol	Në çdo 24 orë	Në mbrëmje. Vaginaletet duhet të lagen dhe të futen sa më thellë
Flagyl, Medazol, Orvagil	Metronidazol	Në çdo 12 – 24 orë	Në mbrëmje. Vaginaletet duhet të lagen dhe të futen sa më thellë
Gyno Dactanol, Gyno Daktarin	Mikonazol	Në çdo 24 orë	Në mbrëmje. Vaginaletet duhet të lagen dhe të futen sa më thellë
Laktovag	Lactobacilus acidofilus	Në çdo 6-8 orë	Futen sa më thellë
Nistatin, Nystatin	Nistatin	Në çdo 24 orë	Në mbrëmje. Vaginaletet duhet të lagen dhe të futen sa më thellë
Palin	Acid pipemidik	Në çdo 24 orë	Në mbrëmje

PREPARATET E KOMBINUARA

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Deltavagin	Fluoroprednizolon + estradiol benzoat + sulfametoksipiridazin + tirotricin + acidi alfaminovalerik	Në çdo 24 orë	Në mbrëmje. Vaginaletet duhet të lagen dhe të futen sa më thellë
Geonistin	Oksitetraciklin + nistatin	Në çdo 24 orë	Në mbrëmje. Vaginaletet duhet të lagen dhe të futen sa më thellë
Polygynax	Acetarsol + neomicin + polimiksin B	Në çdo 24 orë	Në mbrëmje. Vaginaletet duhet të lagen dhe të futen sa më thellë

H. BARNAT SISTEMATIKE HORMONALE ME PËRJASHTIM TË HORMONEVE SEKSUALE

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Dexamethason, Dexason	Deksametazon	Disa herë (e përcakton mjeku)	Terapioni ndërpritet gradualisht. Nuk duhet të përdoret në laktacion
Favistan, Hemotirox	Tiamazol	Në çdo 8 orë	Nuk duhet të merret në shtatzëni dhe laktacion. Shkakton pigmentim të lëkurës, pengesa gastrointenstinale dhe humbje të flokëve
Hydrocortison	Hidrokortizon	Në çdo 12 orë	Në mëngjes dhe në mbrëmje
Kenalog	Triamcinolon	Në çdo 24 orë, me përjashtim të dozave të mëdha në çdo 12 orë	Në mëngjes, pas ushqimit
Nizon , Prednison, Pronison	Prednizolon	Në çdo 24 orë	Në mëngjes, pas ushqimit. Nuk duhet të përdoret në laktacion
Propiltiouracil	Propiltiouracil	Në çdo 8 orë	
Proviron	Mesterolon	Në çdo 6-8 orë	Kujdes në insuficiencën e zemrës, veshkave, mëlçisë, hipertension, epilepsi dhe migren
Tyrax, Tyvoral, Vobenol	Levotiroksin	Në çdo 24 orë	Më së miri në mëngjes

J.BARNAT PËR SHËRIMIN E INFEKSIONEVE SISTEMATIKE – ANTIINFEKTIVËT SISTEMATIKË

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Abactal, Dital	Pefloksacin	Në çdo 12 orë	Tabletat merren me ushqim
Aciklovir, Virolex, Acyclovir, Zovirax	Aciklovir	Në çdo 4 -5 orë	Nuk duhet të merret në laktacion. Shkakton vjellje diare, dhembje koke, edema dhe lodhje
Alfacet, Cefaklor, Taracef	Cefaklor	Në çdo 8 orë, ndërsa forma retarde në çdo 12 orë	Para ushqimit
Almacin, Amoxil, Hiconcil, Sinacilin	Amoksicilin	Në çdo 8 orë	Para ushqimit
Ampicilin, Pentrexyl, Penbritin	Ampicilin	Në çdo 6 orë	Para ushqimit
Amracin, Tetraciklin	Tetraciklin	Në çdo 6 orë	Një orë para ose dy orë pas ushqimit. Nuk duhet të përdoret në shtatzëni dhe laktacion
Bimepen, Mobicin, Ospen, Silapen	Benzatin fenoksimetilpen icilin	Mbi moshën 6 vjeçare në çdo 6 orë, ndërsa nën këtë moshë në çdo 8 orë	Para ushqimit
Cefalexin, Ceporex, Palitrex	Cefaleksin	Në çdo 6 orë (250 mg). Në çdo 8-12 orë (500 mg). Fëmijët në çdo 8-12 orë (100-150 mg)	Para ushqimit
Cenin, Ciprinol, Ciprocinol , Ciprofloksacin	Ciprofloksacin	Në çdo 12 orë	Me pak ujë, para ushqimit

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Chloramphenicol	Kloramfenikol	Në çdo 6-8 orë	Para ushqimit. Nuk duhet të përdoret në shtatzëni dhe laktacion
Cliacil, Penicillin V	Fenoksimetil penicilin kaliumi	Në çdo 8-12 orë	Gjysmë ore para ushqimit
Cloxacilin, Kloksacilin, Orbenin	Cloksacilin	Në çdo 6 orë	Një orë para ose dy orë pas ushqimit
Combantrin	Pirantel	10mg/kg menjëherë, të përsëritet mbas 2 javësh	
Doksiciklin, Dovicin, Vibramycin	Doksiciklin	Ditën e pare në çdo 12 orë, pastaj në çdo 24 orë	Pas ushqimit. Nuk duhet të përdoret në shtatzëni dhe laktacion
Efloran, Flagyl, Medazol, Orvagil	Metronidazol	Në çdo 8-12 orë	Ushqimi nuk ndikon në resorbim.
Egocin, Oksitetraciklin, Teramycin, Oxytetracyclin	Oksitetraciklin	Në çdo 6 orë	Mos të përdoret së bashku me qumësht dhe derivatet e qumështit. Nuk duhet të përdoret në shtatzëni dhe laktacion
Eritromicin, Erythromotrop	Erytromicin	Në çdo 6 orë	Nuk duhet të merret te dëmtimet e mëlçisë, dëmtimet e dëgjimit dhe shtatzëni. Shkakton vjellje dhe diare.
Etambutol, Etamol, Myambutol	Etambutol	Në çdo 24 orë	Me ushqim
Fasigyn, Triagil	Tinidazol	Në bazë të rekomandimit 1-5 ditë (doza merret menjëherë)	Pas ushqimi
Griseofulvin	Griseof ulvin	Në çdo 6 orë	Pas ushqimit

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Hemomycin Sumamed,	Azitromicin	Në çdo 24 orë	Një orë para ose dy orë pas ushqimit
Isoniazid	Izoniazid	Në çdo 24 orë	Një orë para ose 2 orë pas ushqimit
Klindamicin , Klimicin	Klindamicin	Në çdo 6 orë	Para ushqimit. Nuk duhet të merret në shtatzëni. Shkakton dhembje të stomakut, vjellje dhe diare
Lincocin, Lincochem Neloren,	Linkomicin	Në çdo 6–8 orë	Nuk duhet të merret në shtatzëni. Shkakton dhembje të stomakut, vjellje dhe diare
Macropen	Midekamicin	Në çdo 8 orë	Para ushqimit
Mebendazol, Soltrik, Vermox	Mebendazol	Mbi moshën 2 vjeçare 100 mg menjëherë, te rastet e veçanta përsëritet pas 2-4 javë 2 x 100 mg etj.	Nuk duhet të përdoret në shtatzëni , laktacion dhe nën moshën 2 vjeçare. Shkakton dhembje abdominale ,diare dhe reaksione alergjike
Metaciklin, Rondomycin	Metaciklin	Në çdo 12 orë	Një orë para ushqimit
Nistatin, Nystatin	Nystatin	Tabletat në çdo 8 orë, pikat në çdo 6 orë	Dozat e larta shkaktojnë diare dhe vjellje
Nizoral , Oronazol, Mycoseb,Oromyco sal , Ketokonazol	Ketokenazol	Në çdo 24 orë	Me ushqim
Omnidrox	Cefadroksil	Në çdo 12 orë	
Pyrazinamid	Pirazinamid	Në çdo 12- 24 orë	
Rifamor, Rifampicin, Rimactan	Rifampicin	Në çdo 24 orë Një orë para ose dy orë pas ushqimit.	Nuk merret në shtatzëni, alkoolizëm dhe te verdhëza
Stanicid	Fusidin	Në çdo 8 orë	Nuk duhet të merret në shtatzëni laktacion dhe dëmtim të mëlçisë

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Sulfaguanidin	Sulfaguanidin	2-6gr (4-12 tab.) menjëherë,pasta j 3gr (6 tab) në 4 orë	Në shumë vende të botës është i ndaluar përdorimi
Visiren	Ofloksacin	Në çdo 12 orë	Me pak ujë
Yomesan	Niklozamid	1 g , një orë pas edhe 1g , fëmijët deri në moshën 2 vjeçare ¼ e të rriturve	Me pak ujë, nuk duhet të përdoret ushqimi dhe uji tri orë pas përdorimit

KOMBINIMET E ANTINFEKTIVËVE

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Amoksiklav, Klamoxin, Klavocin	Amoksicilin + acid klavulonik	Në çdo 6-8 orë	
Bactrim, Primotren, Trimosul, Cotrimoxazol	Sulfametoksazol + Trimetoprim	Në çdo 12 orë	Gjatë marrjes së këtij kombinimi duhet të merren sasi të mëdha të ujit. Nuk duhet të përdoret në shtatzani dhe laktacion
Chymociclar	Hidroklorid tetraciklin tripsin + himotripsin	Në çdo 6-8 orë	Para ushqimit
Eutizon B6	Izoniazid + bedoksin	Në çdo 24 orë	Më së miri pas mëngjesit
Helicocin	Amoksicilin + metronidazol	Në çdo 8 orë të dy tabletat menjëherë	Në lukth të zbrazët, gjatë kohës së ushqimit. Nuk duhet të përdoret në shtatzani dhe laktacion
Lidaprim	Sulfametrol + trimetoprim	Në çdo 12 orë	Gjatë marrjes së këtij kombinimi duhet të merren sasi të mëdha të ujit

M.BARNAT QË VEPROJNË NË SISTEMIN E MUSKUJVE ESHTËRORË (BARNAT KUDËR REUMATIZMËS, IBUPROFENI, DIKLOFENAKU ETJ.

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Alopurinol, Zyloric	Alopurinol	Në çdo 8-12 orë	Pas ushqimit
Apranax, Naproksen,	Naproksen natriumi	Në çdo 12 orë	Pas ushqimit
Alendronat Alendor Alendox 70	Alendronat		Merren në mëngjes, pas zgjimit nga gjumi, me një gotë të mbushur me ujë, së paku gjysmë ore para marrjes së ushqimit. Pas marrjes së paku 30 minuta i sëmuri nuk bën të shtrihet.
Arbufen Brufen, Ibuprofen,	Ibuprofen	Në çdo 6-8 orë	Pas ushqimit
Chlorochin, Resochin	Fosfat klorohin	Në çdo 12-24 orë	
Diklofen, Diklofenak, Naklofen, Voltaren	Diklofenak natriumi	Në çdo 8-12 orë	Pas ushqimit
Dugodol	Diflunisal	Në çdo 12 orë	
Elderin , Etodolac, Tarlin	Etodolak	Në çdo 12-24 orë	
Erazon, Roxikam, Remoxicam	Piroksikam	Në çdo 8 -24 orë	Pas ushqimit
Flugalin	Flurbiprofen	Në çdo 8 orë	Pas ushqimit
Indocid, Indometacin	Indometacin	Në çdo 8-12 orë	Gjatë ushqimit
Ketonal, Ketoprofen, Niflam, Knavon	Ketoprofen	Në çdo 6-12 orë	Pas ushqimit
Myoflex, Paraflex	Klorzoksazon	Në çdo 6-12 orë	Pas ushqimit
Nimesulid, Sulidamor, Areuma, Auline	Nimesulid		Pas ushqimit
Phenylbutazon	Fenilbutazon	Në çdo 6-12 orë	Pas ushqimit
Turganil	Acid tiaprotenik	Në çdo 12 orë	Pas ushqimit
Xani	Azapropazon	Në çdo 6-12 orë	Pas ushqimit

PREPARATET E KOMBINUARA

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Renofan , Parafon Ndryshon vetëm doza e përbërësve	Klorzoksazon + paracetamol	Në çdo 6-8 orë	Pas ushqimit

TERAPIONI LOKAL I ANTIREUMATIKËVE

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Arbofen, Brufen, Ibuprofen,	Ibuprofen	Në çdo 8-12 orë	Në shtresë të hollë
Diklofen, Voltaren	Diklofenak natriumi	Në çdo 6-8 orë	Në shtresë të hollë
Erazon, Remoxicam	Piroksikam	Në çdo 8-12 orë	Në shtresë të hollë
Etogel,	Etofenamat	Në çdo 6-12 orë	Në shtresë të hollë
Ketonal	Ketoprofen	Në çdo 6-8 orë	Në shtresë të hollë
Phenylbutazon, Butazolidin	Fenilbutazon	Në çdo 6-8 orë	Në shtresë të hollë

PREPARATET E KOMBINUARA

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Bayolin	Heparinoid + Glikol salicilat + benzil nikotinat	Në çdo 6-12 orë	Në shtresë të hollë
Finalgon	Kapsacin + butoeksietilnikotinat	Në çdo 6-12 orë	Në shtresë të hollë
Miospray	Benzil nikotinat + nikotinamid + mentol	Në çdo 6-12 orë	

N. BARNAT QË VEPROJNË NË SISTEMIN NERVOR QENDROR

ANALGJETIKËT

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Acetisal, Andol, Aspirin	Acid acetilsalicilik	Në çdo 4-6 orë	Pas ushqimit. Nuk duhet të përdoret në shtatzani dhe laktacion si dhe fëmijët nën 12 vjeç
Aminopyrin	Aminofenazon	Në çdo 5-24 orë	
Analgin, Novalgetol, Baralgin M	Noraminofenazon (metamizol)	Në çdo 8-24 orë	Pas ushqimit
Eferalgan, Febricet, Miralgin, Panadon, Paracetamol	Paracetamol	Në çdo 4-6 orë	Tabletat nuk duhet të përdoren më tepër se 10 ditë pa u konsultuar me mjekun.
Eglonyl, Sulpirid	Sulpirid	Në çdo 6 -8 orë	Me pak ujë. Nuk duhet të përdoret në shtatzëni (sidomos në tremujorin e parë) dhe laktacion
Fentanil, Lentanil	Fentanil	Në bazë të indikacionit	
Sandomigran	Pizotifen	Në çdo 8-24 orë	
Tramadol, Trodon	Tramadol	Në çdo 24 orë	

PREPARATET E KOMBINUARA

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Aspirin Plus	Acid acetilsalicilik + acid akorbik	Në çdo 8-12 orë	Pas ushqimit
Avamigran	Ergotamin tartarat + mekloksamin + kamilofin + kofein + propifenazon	Në çdo 12-24 orë	Sipas nevojës

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Caffetin	Kodein + kofein + paracetamol + propifenazon		
Oldon	Acid acetilsalicilik + kofein + paracetamol	Në çdo 12-24 orë	Sipas nevojës
Plivadon	Fenacetin + kodein + kofein + propifenazon	Në çdo 12-24 orë	Sipas nevojës
Saridon	Kofein + parcetamol + propifenazon	Në çdo 12-24 orë	Sipas nevojës

ANTIEPILEPTIKËT, ANTIPARKINSONIKËT, PSIKOLEPTIKËT, PSIKOANALEPTIKËT

Kujdes për personat të cilët drejtojnë makinat dhe të cilët punojnë në vendet ku kërkohet përqëndrim në punë.

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Adumbran, Praxiten	Oksazepam	Në çdo 6-8 orë	
Amyzol, Saroten	Amitriptilin	Në çdo 8 orë	Pas ushqimit
Akineton, Biperidin	Biperidin	Në çdo 8 orë	
Ansilan, Nobriten	Medazepam	Në çdo 8-24 orë	
Apilepsin	Valproat natriumi	Në çdo 12 orë	Pas ushqimit
Apaurin, Bensedin, Diazepam, Valium	Diazepam	Në çdo 8-24 orë	Pas ushqimit Më së miri një orë para gjumit. Nuk duhet të merret në shtatzëni sidomos në tremujorin e parë
Artane, Hexifen	Triheksifenidil	Në çdo 24 orë	
Asamid, Soxinutin	Etosuksemid	Sipas gjendjes(e cakton mjeku)	Pas ushqimit
Demetrin	Prazepam	Në çdo 8 orë	
Difetoin	Fenitoin natriumi	Sipas gjendjes (e cakton mjeku)	Para ushqimit
Flormidal	Midazolam	Në çdo 24 orë	Para gjumit
Fluzepam	Fluzepam	Në çdo 24 orë	Para gjumit
Juprenil	Selegilin	Në çdo 24 orë	Në mëngjes
Ladiomil, Maprotilin	Maprotilin	Në çdo 8 orë	
Largactil	Klorpromazin	Në çdo 8 orë	
Lekotam, Lexaurin, Lexilium	Bromazepam	Në çdo 8-12 orë	Pas ushqimit

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Leponex, Clozapine	Klozapin	Në çdo 8-12 orë	Në mbrëmje
Librium	Klordiazepoksid	Në çdo 8 orë	
Litium karbonat	Karbonat litiumi	Në çdo 12-24 orë	
Loram, Lorsilam	Lorazepam	Në çdo 8-24 orë	
Lyogen, Moditen	Flufenazin	Në çdo 8-12 orë	
Melleril, Mellerete	Tioridazin	Në çdo 12-24 orë	
Meprobamat	Meprobamat	Në çdo 6-8 orë	
Majsolin	Primidon	Në çdo 12-24 orë	
Maprotilin	Maprotilin	Në çdo 8 orë	Shkakton gjumë. Kujdes!
Mazepin, Karbamazepin, Tegretol	Karbamazepin	Në çdo 12 orë	Pas ushqimit
Moditen	Flufenazin klorid	Në çdo 8 –12 orë	
Nozinan	Levopromazin	Në çdo 12-24 orë	2 orë pas ushqimit
Oikamid, Piracetam	Piracetam	Në çdo 8 orë	
Orap forte	Pimozid	Në çdo 12-24 orë	
Phemitoin	Metilfenobarbiton	Sipas gjendjes (e cakton mjeku)	Nuk duhet të përdoret në shtatzani
Phenobarbiton	Fenobarbiton	Në çdo 24 orë	Në mbrëmje. Nuk duhet të përdoret në shtatzani dhe laktacion
Rivotril	Klorazepam	Në çdo 24 orë	Në mbrëmje
Tetidis	Disulfiram	Në çdo 24 orë	
Vivalan	Viloksazin	Në çdo 8-12 orë	
Xanax	Alprazolam	Në çdo 8 orë	

BARNAT E KOMBINUARA

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Madopar HBS, Madopar	Levodopa + bezerazid	Në çdo 8 orë	Pas ushqimit
Nakom	Levodopa + karbidopa	Në çdo 6-8 orë	

P.BARNAT PËR SHËRIMIN E INFEKSIONEVE QË I SHKAKTOJNË PARAZITËT-ANTIPARAZITIKËT

Emri i preparatit	***Përmbajtja***	***Mënyra e përdorimit***	***Vërejtjet***
Combantrin	Pirantel	10 mg/kg menjëherë, të përsëritet mbas 2 javësh	
Efloran, Flagyl, Medazol, Orvagil	Metronidazol	Në çdo 8-12 orë	Ushqimi nuk ndikon në resorbim.
Fasigyn, Triagil	Tinidazol	Në bazë të rekomandimit 1-5 ditë (doza merret menjëherë)	
Griseofulvin	Griseofulvin	Në çdo 6 orë	Pas ushqimit
Mebendazol, Soltrik, Vermox	Mebendazol	Mbi moshën 2 vjeçare 100 mg menjëherë, te rastet e veçanta përsëritet pas 2-4 javë 2 x 100 mg etj. Në të njëjtën mënyrë edhe shurupi (Në çdo 12 orë nga 5 ml)	Fëmijëve tabletën duhet grimëcuar dhe përzier me ushqim apo lëngje, të rriturit me pak ujë
Nistatin, Nystatin	Nystatin	Në çdo 8 orë	
Nizoral , Oronazol, Mycoseb,Oromyco sal, Ketokonazol	Ketokenazol	Në çdo 24 orë	Me ushqim
Yomesan	Niklozamid	1 g , një orë pas edhe 1g , fëmijët deri në moshën 2 vjeçare ¼ e të rriturve	Me pak ujë, nuk duhet të përdoret ushqimi dhe uji tri orë pas përdorimit

R.BARNAT QË VEPROJNË NË SISTEMIN RESPIRATOR

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Aloprol, Spalmotil, Ventolin, Salbutamol	Salbutamol	Në çdo 6-8 orë	Pas ushqimit
Alupent	Orciprenalin sulfat	Në çdo 6-24 orë	
Alvesco	Ciklezomid		Marrja e barit është e preferuar në mbrëmje
Aminuphyllinum, Aminofilin	Aminofilin	Në çdo 6-8 orë	Pas ushqimit
Avil	Feniramin	Në çdo 6-8 orë	Kujdes drejtuesit e automjeteve. Nuk duhet të përdoret në shtatzëni
Becotide	Beklometazon dipropionat	Në çdo 6-24 orë	Pas ushqimit
Benil, Imidin, Nafzol	Nafazol	Në çdo 4-12 orë	Më së shumti tri ditë Hundët pastrohen dhe respektohen pozitat e trupit gjatë aplikimit dhe pas aplikimit.
Berotec	Fenoterol bromid	Në çdo 8-24 orë	
Bisolvon, Bisolex, Bromexin	Bromeksin	Në çdo 8 orë	
Broncho munal	Lizat bakterje	Në çdo 24 orë	
Bronles, Mucodin, Fenorin, Karbocistein	Karbocistein	Në çdo 8 orë	Për të arritur efektin e dëshiruar duhet të përdoret rregullisht dhe një kohë të gjatë
Codeini phosphas	Kodein fosfat	Në çdo 4-6 orë	

Emri i preparatit	*Përmbajtja*	*Mënyra e përdorimit*	*Vërejtjet*
Dihalar, Galitifen, Ketotifen	Ketotifen	Në çdo 12-24 orë	Gjatë ushqimit
Durofilin, Teofilin, Teotard	Teofilin	Në çdo 6-12 orë	Pas ushqimit
Ephedrin	Efedrin	Në çdo 8 orë	Para ushqimit. Më së shumti 5 ditë Hundët pastrohen dhe respektohen pozitat e trupit gjatë aplikimit dhe pas aplikimit.
Gnadion, Beconaze	Beklometazon dipropionat	Në çdo 8-12 orë (pikat), aerosoli në çdo 24 orë	
Hydrophyllin	Diprofilin	Në çdo 8 orë	
Intal	Kromoglikat natriumi	Në çdo 6 orë	Kapsulat duhet të përegatiten për t'u përdorur me inhalator
Lontermin	Prokaterol	Në çdo 12 orë	
